



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 30 prot.

Kamëz, më 27.3 2026

V E N D I M  
Nr. 27 .Datë 27/3 2026  
M B I

**“MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MBROJTJES SË FËMIJËVE 2026-2030”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.3.2026, pasi mori në shqyrtim Projektvendimin Nr.23 Datë 25.03.2026 në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “Për Strehimin Social” ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Për Barazinë Gjinore” si dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Planit Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve 2026-2030”.
2. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI














**PLANI VENDOR**  
**PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE**  
**2026 - 2030**

*PËRGATITUR NGA BASHKIA KAMËZ NË BASHKËPUNIM ME ORGANIZATËN  
NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR ARSIS*

MARS 2026

Plani Vendor për Mbrojtjen e Fëmijëve (PVMF) 2026–2030 u përgatit nga Bashkia Kamëz, si mjeti kryesor për zbatimin e e përgjegjësive dhe angazhimeve institucionale në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

**Grupi i punës:**

1. Marime Vladi- Drejtor, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale; 
2. Farida Halili- Drejtor Pallati i Kulturës; 
3. Eralda Allushi – Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve, Drejtoria e Ndhmes Ekonomike dhe Çështjeve Sociale; 
4. Ervisjana Marqeshi- Specialist NjVNR, Drejtoria e Ndhmes Ekonomike dhe Çështjeve Sociale; 
5. Bleona Manjani- Specialist i Mbrojtjes së Femijëve, Drejtoria e Ndhmes Ekonomike dhe Çështjeve Sociale; 
6. Sajmir Kurti, Këshilli Bashkiak;
7. Arjola Topalli, Specialiste psikologe, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit; 
8. Behije Aga, Specialiste, Gjendja Civile Kamëz; 
9. Blertina Kaleshi, Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijëve, Lagje Administrative Bathore; 
10. Enkeleda Brati, Përgjegjëse e Sektorit të Strehimit, Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile. 

## TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtime.....	2
1. Hyrje .....	3
2. Konteksti & Analiza e situatës.....	7
3. Kuadri ligjor dhe institucional.....	9
4. Metodologjia.....	12
5. Vizioni, qëllimi dhe objektivat smart.....	13
6. Qeverisja dhe mekanizmat e kordinimit.....	14
7. Shtyllat strategjike .....	14
8. Monitorim & Vlerësim (M&V) .....	16
9. Etika, Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të dhënave.....	16
10. Aneksë.....	17
11. Plani i Veprimit – Matrica Operacionale.....	19

# Shkurtime

PVMF- Plani Vendor për Mbrojtjen e Fëmijëve  
NJMF- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve  
PMF- Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve  
ETN- Ekipi Teknik Ndërsektorial  
GTN- Grupi Teknik Ndërsektorial  
BK- Bashkia Kamëz  
DNEÇS- Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale  
PSV- Procedurat Standarde të Veprimit

## 1. HYRJE

---

Plani Vendor për Mbrojtjen e Fëmijëve (PVMF) 2026–2030 u përgatit nga Bashkia Kamëz, si mjeti kryesor për zbatimin e përgjegjësisë dhe angazhimeve institucionale në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Bashkia Kamëz përballet me një kërkesë të qëndrueshme dhe të lartë për shërbime mbrojtjeje sociale dhe mbështetje për fëmijët dhe familjet vulnerabël. Raste të dhunës, neglizhencës, situatave të rrugës, mungesës së kujdesit prindëror dhe vështirësive socio-ekonomike kërkojnë reagim të koordinuar, të shpejtë dhe të plotë gjatë gjithë vitit. Ndërsa vitet e fundit janë krijuar struktura funksionale si sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore dhe Qendra Multifunksionale.

Plani Vendor 2026–2030 synon të forcojë sistemin lokal të mbrojtjes së fëmijëve, të standardizojë protokollat ndërinstitucionale dhe të zgjerojë paketën e shërbimeve për fëmijën dhe familjen, në mënyrë që identifikimi, referimi dhe ndërhyrja të jenë të hershme, efikase dhe të bazuara në të dhëna. Qëllimi është që çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kamëz të ketë akses të barabartë dhe të sigurt në mbrojtje, arsim, shëndetësi dhe mbështetje psiko-sociale, duke minimizuar institucionalizimin dhe duke forcuar kujdesin familjar.

Aktualisht, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Bashkia Kamëz ndërmori hapat e nevojshëm për të përgatitur dhe miratuar Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në funksion të përmbushjes së kërkesave që rrjedhin nga procesi i integritit në Bashkimin Evropian.

Plani Vendor për Mbrojtjen e Fëmijëve (PVMF) 2026-2030 u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me të gjitha drejtoritë e bashkisë, njësitë administrative, institucionet publike vendore, mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve, organizatat e shoqërisë civile, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Plani Vendor 2026–2030 synon të forcojë sistemin lokal të mbrojtjes së fëmijëve, të standardizojë protokollat ndërinstitucionale dhe të zgjerojë paketën e shërbimeve për fëmijën dhe familjen, në mënyrë që identifikimi, referimi dhe ndërhyrja të jenë të hershme, efikase dhe të bazuara në të dhëna. Qëllimi është që çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kamëz të ketë akses të barabartë dhe të sigurt në mbrojtje, arsim, shëndetësi dhe mbështetje psiko-sociale, duke minimizuar institucionalizimin dhe duke forcuar kujdesin familjar.

Gjatë periudhës së zbatimit, priten ndryshime të matshme dhe të qëndrueshme:

- Rritje e aksesit në shërbime për fëmijët dhe familjet në risk, duke dyfishuar mbulimin në lagjet dhe nën-njësitë më të prekura.
- Rikthimi dhe ruajtja e frekuencimit në arsim për të paktën 100 fëmijë me risk braktisjeje, përmes këshillimit, lidhjes me ndihmën ekonomike dhe programeve të punësimit për prindërit.
- Ulja me të paktën 40% e numrit të fëmijëve në situatë rruge, përmes identifikimeve në terren nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe të referimit, planeve individuale të ndërhyrjes dhe protokolleve me Policinë dhe ZVA.
- Riintegrim familjar i qëndrueshëm për fëmijët pa kujdes prindëror ose në institucion, me mbështetje pas-riintegrimi dhe monitorim të vazhdueshëm.

- Trajnim i detyrueshëm për stafin dhe partnerët në safeguarding/PSEA, menaxhim rasti, protokollet e emergjencës dhe kujdes alternativ.

Ky plan vendor e shndërron përvojën dhe praktikën e mira të viteve të fundit në një sistem të qëndrueshëm lokal për mbrojtjen e fëmijëve. Ai vendos mekanizma të qartë funksionale që sigurojnë ndërhyrje të shpejtë dhe të koordinuar, jo vetëm gjatë orarit zyrtar, por 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Për herë të parë, raportimi dhe reagimi institucional standardizohen, duke garantuar që asnjë rast urgjent të mos mbetet pa mbështetje.

Plani do të përfshijë masa të përbashkëta ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Komisarariatit të Policisë me qëllim mbrojtjen e individëve dhe fëmijëve nga të gjitha format e keqtrajtimit dhe shfrytëzimit në situatë rruge, përmes mekanizmave të identifikimit, ndihmës së menjëhershme dhe referimit të duhur dhe do të zhvillojë vizita sistematike në zonat periferike të qytetit. Kjo qasje siguron që fëmijët dhe familjet që jetojnë larg qendrave të shërbimit të mos mbeten jashtë sistemit të mbrojtjes.

Referuar rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, Bashkia Kamëz do të vijojë të ofrojë shërbimin lëvizës në ambientin familjar, duke mundësuar që fëmijët me vështirësi emocionale, sjellore ose zhvillimore të marrin mbështetje profesionale brenda komunitetit të tyre, pa pasur nevojë të referohen jashtë bashkisë ose në institucione rezidenciale.

Pa një plan vendor të strukturuar, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve mbetet i fragmentuar dhe reaktiv. Pa objektiva dhe buxhet të përcaktuar, bashkia nuk ka argument të plotë për të kërkuar fonde nga Fondi Social ose burime të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Mungesa e protokolleve të standardizuara të emergjencës dhe e shkëmbimit të të dhënave rrit rrezikun që fëmijët në situata të vështira të mbeten pa mbështetje ose të humbasin në procesin e referimit midis institucioneve.

Matja e progresit është një tjetër sfidë: pa indikatorë, të dhëna të strukturuar dhe mekanizma monitorimi, nuk është e mundur të vlerësohet realisht ndikimi i shërbimeve. Ky plan vendos një kornizë të qartë të përgjegjësisë, afateve dhe burimeve, duke forcuar rolin e Bashkisë Kamëz si garantuese e të drejtave të fëmijëve dhe duke krijuar një model të replikueshëm edhe në bashki të tjera, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Zbatimi do të mbështetet financiarisht nga Bashkia Kamëz dhe fondet e dedikuara për shërbimet sociale në komunitet. Për më tepër, plani parashikon partneritete me organizata jofitimprurëse të cilat do të kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve të specializuara, fushatave ndërgjegjësuese, mbështetjes për familjet dhe ndërhyrjeve të terrenit. Buxheti do të mbulojë shërbime njerëzore, terapi zhvillimore, logjistikë për ekipet lëvizëse, sistemin e menaxhimit të të dhënave, trajnime dhe aktivitete komunitare.

Bashkia Kamëz ka konsoliduar vitet e fundit një ekosistem vendor shërbimesh për fëmijët dhe familjet në situatë vulnerabël, duke u mbështetur te struktura e Mbrojtjes së Fëmijës, njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, si edhe te Qendra Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara. Përmes tryezave ndërsektoriale me Zyrën Arsimore, Qendrat Shëndetësore, Komisariatin e Policisë nr. 5, Zyra e Punës dhe organizatave partnere janë vendosur praktika të rregullta koordinimi, vizita në terren dhe menaxhim i standardizuar i rasteve. Gjatë vitit të fundit janë trajtuar raste që prekin dhunën ndaj fëmijëve, situatat e rrugës, sfidat socio-ekonomike të familjeve, mungesën e kujdesit prindëror dhe riatdhesimet, duke reflektuar një nevojë të qartë për

shërbime të integruara dhe reagim të shpejtë 24/7. Qendra Multifunkionale ofron logopedi, terapi zhvillimore, këshillim psikologjik dhe fizioterapi, me rritje të kërkesës dhe nevojë për konsolidim kapacitetesh, reduktim të listave të pritjes dhe matje më të mirë të progresit të fëmijëve.

Në këtë kontekst, prioritet mbetet forcimi i mekanizmave të referimit dhe protokolleve operacionale për situatat emergjente që ta shtrijë mbështetjen për fëmijët në situatë rruge gjatë gjithë vitit, jo vetëm sezonalisht. Parandalimi i institucionalizimit dhe orientimi drejt zgjidhjeve familjare, si kujdesi alternativ me dhe pa lidhje gjaku, (kinship care) dhe riintegrim i qëndrueshëm, kërkojnë fushata të dedikuara për rekrutimin e familjeve kujdestare dhe paketa mbështetëse për pas rikthimit/vendosjes së fëmijës në familje, që stabilizojnë mirëqenien e fëmijës. Në të njëjtën kohë, rikthimi dhe mbajtja e fëmijëve në arsim duhet të kombinohet me tutorim dhe mbështetje socio-ekonomike për prindërit, duke u lidhur me skemat e ndihmës ekonomike, punësimin dhe trajnimin profesional. Dimensioni i politikave të mbrojtjes (kodi i etikës, përdorimi i të dhënave, mënyra e trajtimit të fëmijëve dhe përfituesve të rritur) me trajnime të detyrueshme për personelin dhe audit të aksesit në të dhëna, siguron përgjigje të standardizuar ndaj dhunës dhe rrezikut.

Për të siguruar monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e rezultateve, çdo rast raportohet çdo 3 muaj pranë ASHDMF-së, duke mundësuar një analizë të detajuar tremujore dhe një vlerësim të plotë vjetor të ecurisë. Kjo do të kontribuojë në rritjen e cilësisë dhe llogaridhënies, ndërkohë që respektohen plotësisht standardet e etikës, konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave dhe kërkesat e Ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave.

Punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve përdorin sistemin e SHKSH-së për të monitoruar dhe menaxhuar rastet e fëmijëve në situata të rrezikut ose atyre që kanë nevojë për mbrojtje dhe mbështetje sociale. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë një qasje të koordinuar dhe të strukturuar ndërmjet institucioneve dhe shërbimeve që merren me mbrojtjen e fëmijëve. PMF-të regjistrojnë çdo rast të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në sistemin e SHKSH-së. Ky regjistër është digjital dhe mundëson ruajtjen e të dhënave të përditësuara të çdo rasti.

Bashkëfinancimi vendor, Fondi Social dhe partneritetet me OJF-të janë faktorë kyç për ta mbajtur ciklin e shërbimeve të plotë, nga identifikimi, tek ndërhyrja e hershme, shërbimet e specializuara, mbështetja familjare dhe riintegrimi, me synimin që fëmijët dhe familjet e Kamzës të kenë akses më të shpejtë, më të barabartë dhe më cilësor në shërbime dhe mbështetje.

Rezultatet e pritshme për periudhën 2026–2030 përfshijnë rritje të dukshme të aksesit në shërbime, ulje të rasteve të fëmijëve në situatë rruge, rritje të riintegrimi familjare dhe përmirësim të qëndrueshëm të cilësisë së menaxhimit të rasteve, të mbështetura nga të dhëna të besueshme dhe kapacitete të fuqizuara profesionale.

Pse duhet një plan vendor për mbrojtjen e fëmijëve:

**Pajtueshmëri ligjore dhe qartësim rolesh:** për të zbatuar detyrimet e bashkisë në mbrojtjen e fëmijës, për të përcaktuar kush bën çfarë (Punonjës për mbrojtjen e fëmijëve, shkollat, qendrat shëndetësore, Policia, OJF-të) dhe si bashkërendon puna në praktikë (procedurat standarde të veprimit, rregullore, kalendar takimesh).

**Koordinim i duhur ndërsektorial 24/7:** të gjithë aktorët ndjekin të njëjtin protokoll për raportim/referim, reagim emergjent dhe ndarje të të dhënave, që rastet të mos humbasin mes institucioneve.

**Prioritizim dhe buxhetim:** planifikon çfarë duhet bërë së pari, sa kushton dhe nga sigurohen fondet (buxhet vendor, Fondi Social, Fondi Social Vendor, donatorë). Pa plan, nuk ke arsyetim të fortë për buxhet dhe rrezikon ofrimin e shërbimeve apo shërbime të munguara.

**Shërbime të targetuara:** e lidh identifikimin e hershëm me shërbime të specializuara (qendra multifunksionale/terapi), NJVNR për fëmijët në situatë rruge, dhe paketa mbështetëse për familjet, fushata të organizuara dhe periodike.

**Parandalim i institucionalizimit & kujdesi alternativ në familje:** vendos objektiva realë për kujdesin alternativ/kinship dhe riintegrim, me mbështetje afatgjatë post-riintegrimi dhe indikatorë matës.

**Monitorim dhe Vlerësim, si dhe vendimmarrje bazuar në të dhëna:** regjistër vendor dhe dashboard ndihmon në përgatitjen e raporteve tremujore/vjetore, baseline/targete dhe nxjerrje mësimesh (përshatje dhe menaxhim).

**Politikat e mbrojtjes për punonjësit, përfituesit, mbrojtja nga ngacmimet në vendin e punës dhe mbrojtja e të dhënave** standardizojnë etikën, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave duke mbrojtur fëmijët, stafin dhe vetë imazhin publik të bashkisë nga risqet ligjore dhe reputacionit.

**Kualifikim i personelit dhe qëndrueshmëri:** trajnimet dhe supervizimi profesional sigurojnë standard të njëjtë pune edhe kur ka lëvizje të stafit, ndërsa plani ruan kujtesën institucionale.

**Besueshmëri dhe financim:** donatorët dhe partnerët kërkojnë plan të qartë me logframe, indikatorë dhe buxhet. Plani lehtëson mundësimin dhe përthithjen e fondeve dhe siguron impakt.

**Transparencë ndaj komunitetit:** tregon publikisht çfarë synon bashkia, si do e arrijë dhe si matet sukcesi, duke rritur besimin e qytetarëve, përfshirjen e prindërve dhe të fëmijëve.

Pra, plani vendor e kthen “vullnetin e mirë” në sistem: prioritetet, procedura, fondet dhe rezultatet për të cilat merret angazhim, dokumentohen, maten dhe mbrohen, me synim që çdo fëmijë në Kamëz të ketë akses më të shpejtë, më të barabartë dhe më cilësor në shërbime dhe mbështetje.

## 2. Konteksti & Analiza e situatës

### Karakteristikat e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje:

- 35 raste të fëmijëve të menaxhuar gjatë vitit 2025 lidheshin me problemet social ekonomike të familjeve të tyre;
- 8 fëmijë u identifikuan në situatë rruge;
- Kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës 22 fëmijë, nga të cilët: 3 fëmijë përjetuan dhunë fizike, 2 fëmijë dhunë seksuale dhe 17 fëmijë dhunë psikologjike;

- 6 rast fëmijësh u identifikuan të neglizhuar nga prindi/prindërit;
- Janë menaxhuar gjatë vitit të analizuar 11 raste fëmijësh në konflikt me ligjin ;
- Janë menaxhuar gjatë vitit të analizuar 5 raste të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- Janë menaxhuar 2 raste trafikimi;

Nxitja e të gjithë aktorëve të përfshirë për të qënë pjesë kontribuese në përmirësimin e situatës së çdo familjeje të identifikuar ka qënë fokus i punës së NJMF pranë Bashkisë Kamëz. Planet individuale të zhvillimit për secilin fëmijë dhe plani i fuqizimit të familjes janë trajtuar në tryezat teknike me një qasje multidisiplinare duke bërë pjesëmarrës edhe vetë familjarët, duke u njohur atyre të drejtën legjitime për të ardhmen e fëmijës dhe përgjegjësinë prindërore.

Organizatrat joqeveritare të mbështetura nga donatorë, në Kamëz kanë luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në ofrimin e shërbimeve për target grupe si gratë, fëmijët, PAK dhe familjet, por edhe në kontributin e dhënë për ofrimin e programeve të ndryshme për rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin të fëmijëve dhe të rinjve mbi të drejtat e tyre dhe grupeve vulnerabël, apo mbështetjen dhe fuqizimin e kategorive të ndryshme si të rinjtë dhe gratë.

OJF-të konsiderohen si një strukturë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, pasi mund të veprojnë edhe më shpejt sesa institucionet publike dhe kanë mundësi për të ofruar një cikël të plotë të shërbimeve.

Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm dhe OJF, ka ofruar shërbime të vazhdueshme për rastet e menaxhuara, ndër të cilat mund të përmendim:

- Ndhmë Ekonomike;
- Raste të veçanta nga fondet e bashkisë;
- Bonuse për subvencionim të qirasë ose interesave të kredisë;
- Këshillim psikologjik dhe ligjor;
- Punësim;
- Mbështetja me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare;
- Pajisje Elektroshtëpiake;
- Përfshirja në kurse profesionale;
- Shërbimi lëvizës
- Transport social.

Shërbimet e tjera specifike që mund të përmendim për rastet janë: këshillim psiko-social, asistencë për plotësimin e nevojave bazike (ushqim-veshmbathje), asistencë mjekësore, asistencë ligjore, ofrim kursesh social-edukuese, mbështetje me transport, përfshirjen në aktivitete që nxisin dhe zhvillojnë aftësitë sociale, mbështetje me materiale didaktike për vazhdimin e shkollës, ofrimi i shërbimit logopedik/terapisë së zhvillimit, mbështetje për punësimin e prindërve të tyre etj.

Krahas menaxhimit të rasteve një fokus të veçantë marrin edhe aktivitetet sensibilizuese për ndërgjegjësimin dhe PMF-të (Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve) luajnë një rol kyç në realizimin e këtyre aktiviteteve. Ato janë të orientuara për të edukuar dhe ndërgjegjësuar komunitetin,

familjet, dhe individët rreth të drejtave të fëmijëve dhe rreziqeve që mund të përballen ata, si dhe për të nxitur mbështetje për fëmijët në nevojë.

Spektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjimore në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Kamëz, organizatat që veprojnë në zonë, përfaqësues të komisarariatit nr.5, kanë zhvilluar një sërë aktiviteteve nëpër shkollat të ndryshme të Bashkisë Kamëz dhe në komunitet.

Bashkia Kamëz i ka kushtuar vëmendje të veçantë kategorisë vulnerabël që banon në territorin administrativ të bashkisë dhe veçanërisht personave me aftësi të kufizuara. Vitet e fundit Bashkia Kamëz ka patur prioritet projektimin dhe ndërtimin e një mjedisi urban që i përshkruan çdo kategori ndaj janë bërë të gjithë përpjekjet për ta projektuar qytetin në shërbim të të gjithë përdoruesëve duke siguruar kështu një ndërveprim social në jetën e banorëve. Kryesisht rrugët, trotuarët, institucionet arsimore, një pjesë e institucioneve shëndetësore dhe të gjithë objektet e ndërtuara rishtazi, janë tashmë të aksesueshme dhe të përdorshme edhe nga personat me aftësi të kufizuara.

Një ndihmesë shumë e madhe për këtë kategori është Qendra Multifunktionale për fëmijët me AK (ngritur në tetor të vitit 2022), e cila u përgjigjet nevojave të vlerësuara nga përvoja praktike, të adresuara për ngritjen e shërbimeve të reja dhe inovative të pushtetit vendor, duke synuar ofrimin e shërbimeve të integruara shëndetësore për fëmijët me nevojat të veçanta me qëllim mirëqënien e cilësisë së jetës së individit dhe familjes. Përgjatë vitit 2025, janë 85 raste të fëmijëve që marrin shërbime të ndryshme nga Multifunktionale për fëmijët me AK si: *shërbim logopedik ose terapi e të folurit; shërbim psikologjik; këshillim; terapi zhvillimi; fizioterapi dhe rehabilitim fizik.*

Në territorin e Bashkisë Kamëz ofrojnë shërbime për fëmijët, Bashkia Kamëz dhe organizatat bashkëpunëtoare që operojnë brenda territorit dhe jo vetëm. Ka një rrjet të gjerë organizatash që ofrojnë shërbim për fëmijët ku mund të përmendim: World Vision, QDNJD, Global Care, Caritas, Olive for Charity, Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, Të ndryshëm dhe të barabartë, Ndihma Juridike Falas, SHKEJ.

Gjatë këtyre viteve, nisur nga nevojat e identifikuar, rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe familjet e tyre mbështeten nga fondet e bashkisë që shkon përtej paketave ushqimore dhe përfshin edhe aspekte të tjera si mbështetja me bonus qeraje apo ndihmë ekonomike. Në bashkëpunim me OJF partnere mbështetja është dhe më e madhe.

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale ka ndërmarrë një sërë nismash të suksesshme, të orientuara strategjikisht drejt lehtësimit të vështirësive për shtetasit më vulnerabël të komunitetit. Këto ndërhyrje janë konceptuar dhe zbatuar në funksion të garantimit të aksesit të barabartë në shërbime, fuqizimit social dhe integritit të grupeve në nevojë në jetën sociale dhe ekonomike të bashkisë. Ndër këto mund të përmendim:

- Nënshkrimi i Kartës së Barazisë Gjimore në Maj të vitit 2020;
- Ngritja e Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjimore në shtator të vitit 2020;
- Ndarja funksionale dhe administrative e sektorit të Ndihmës Ekonomike nga sektori i Personave me Aftësi të Kufizuara, me qëllim specializimin e shërbimeve dhe përmirësimin e efikasitetit në trajtimin e kategorive përkatëse në vitin 2022;
- Ngritja e Qendrës Multifunktionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në tetor të vitit 2022;
- Miratimi i Planit Social Vendor 2021–2023 përfaqëson një nga arritjet kryesore të

Bashkisë Kamëz në fushën e zhvillimit social, duke vendosur një kuadër të qartë strategjik për identifikimin dhe adresimin e nevojave të komunitetit, përmirësimin e shërbimeve sociale dhe fuqizimin e mekanizmave të përfshirjes sociale;

- Hartimi i një plan masash të përbashkëta (Bashkia Kamëz-Komisariati i Policisë nr.5) për parandalimin dhe zbutjen e fenomenit të individëve në situatë rruge në territorin e Bashkisë Kamëz (çdo vit në periudhën e verës);
- Më 2 dhjetor të vitit 2020 janë nënshkruar për herë të parë 2 protokolle shumë të rëndësishme, si Protokollin e Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel Vendor përmes Mekanizmit të Kordinuar të Referimit, kjo me qëllimin për të standartizuar veprimet e nevojshme për reagim të menjëhershëm gjithëpërfshirës dhe me përgjegjshmëri në mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të dhunës në familje;
- Miratimi i Planit Social Vendor 2024–2026;
- Miratimi i Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2030 si mjeti kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.
- Shërbim lëvizës;
- Transport social.

### **3. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL**

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, duhet të kemi parasysh se e drejta për mbrojtje, mirëqenie dhe zhvillim të plotë të fëmijës buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila është dokumenti më i lartë ligjor në hierarkinë normative të vendit.

Në nenin 18 të Kushtetutës sanksionohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, i cili zbatohet edhe për fëmijët, ndërsa neni 54 parashikon në mënyrë të posaçme se:

“Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë nga shteti.”

Ky parashikim kushtetues vendos bazën ligjore për ndërtimin dhe zbatimin e politikave publike në mbrojtje të fëmijëve, duke garantuar interesin më të lartë të fëmijës si parim udhëheqës në çdo ndërhyrje apo vendimmarrje që i prek ata.

Kjo mbrojtje de jure e fëmijëve është gjithashtu e konsoliduar në një sërë instrumentesh ndërkombëtarë, të ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë, të cilët zënë vend menjëherë pas Kushtetutës në hierarkinë ligjore të vendit. Në rastet kur legjislacioni vendas nuk jep zgjidhje të qartë për një çështje të caktuar, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e instrumenteve ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Mbrojtjes së Fëmijëve 2026–2030 mbështetet në këtë kuadër të gjerë ligjor, institucional dhe politikash, duke shërbyer si instrument kyç për parandalimin, identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe për garantimin e të drejtave të tyre në nivel vendor.

#### **a) Instrumente ndërkombëtarë**

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), në aspektin e mbrojtjes së fëmijëve viktime ose dëshmitarë të dhunës;
- Udhëzimet dhe rekomandimet e UNICEF, Këshillit të Evropës dhe Komitetit për të Drejtat e Fëmijës.

#### **b) Kuadri ligjor kombëtar**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”;
- Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7895/1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7905/1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, i ndryshuar, etj.

#### **c) Politikat kombëtare**

Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë Plan Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve 2026–2030 janë në përputhje dhe mbështeten në politikat dhe strategjitë kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht:

- Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030;
- Strategjitë sektoriale në arsim, shëndetësi, drejtësi, strehim dhe punësim.

#### **d) Institucionet përgjegjëse**

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, bashkitë janë përgjegjëse kryesore për zbatimin e politikave dhe masave për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor. Në këtë kuadër, rolin kyç e luajnë:

- Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF);
- Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF);
- Strukturat e shërbimeve sociale në bashki;
- Njësitë administrative;
- Këshilli Bashkiak dhe komisionet përkatëse të tij.

Plani Vendor i Mbrojtjes së Fëmijëve nuk është përgjegjësi e një strukture të vetme, por një dokument institucional i Bashkisë, për zbatimin efektiv të të cilit përgjegjësi mbajnë të gjitha drejtoritë, njësitë administrative dhe strukturat vendore në bashkëpunim të ngushtë me institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Për të garantuar zbatimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të PVMF-së, Bashkia parashikon ngritjen dhe funksionalizimin e një Grupi Ndërsektorial për Mbrojtjen e Fëmijëve / Grupi Monitorues, i përbërë nga përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe aktorëve lokalë.

Ky grup do të sigurojë koordinimin institucional, përfshirjen e perspektivës së të drejtave të fëmijës në të gjitha politikat dhe dokumentet zhvillimore të bashkisë, si dhe adresimin e nevojave të fëmijëve në të gjithë diversitetin e tyre.

Në këtë proces, roli i institucioneve vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare mbetet thelbësor, veçanërisht përmes mbështetjes teknike dhe financiare për zbatimin e masave të parashikuara në Planin Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve.

#### 4. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVMF 2026 - 2030 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Ngritja e Grupit të Punës.** Grupi i Punës për hartimin e këtij PVMF u ngrit me Urdhër të Kryetarit, nr.119, datë 10.02.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve.
- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk revieë).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.
- **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t’u përfshirë në matricën e PVMF 2026-2030.** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioritetëve, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë.

- **Konsultimet paraprake brenda bashkisë.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratorët/administratoret e NJA-ve. Janë zhvilluar gjithsej *tre takime të Grupit të Punës*, përkatësisht në datat 12.02.2026, 19.02.2026, dhe 27.02.2026.
- **Konsultim me një grup të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh.** Grupi i Punës mendoi që në takimin e tretë të tij (përkatësisht në datën 27.02.2026) të ftonte edhe një rreth të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh, për të diskutuar parimisht mbi përmbajtjen e PVMF. Ky takim rezultoi i suksesshëm, me diskutime e propozime konkrete nga të ftuarat/ftuarit.
- **Përgatitja e draft dokumentit të PVMF 2026 - 2030.** Drafti matrica e përgatitur për konsultim përmbante masat dhe veprimet e parashikuara të përfshira në dhjetë shtylla strategjike. Në këtë draft u reflektuan vazhdimisht të gjitha ndryshimet e dakortësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.
- **Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.** Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, si dhe anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit Bashkiak.
- **Miratimi i PVMF 2026 – 2030 në Këshillin Bashkiak.** Versioni përfundimtar i PVMF i konsultuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVMF 2026 – 2030 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë.

## **5. VIZIONI, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT SMART**

**Vizioni:** “*Të gjithë fëmijët e Bashkisë Kamëz, vajza dhe djem, pavarësisht moshës, vendbanimit, përkatësisë etnike e sociale, aftësisë së kufizuar apo nevojave të veçanta, statusit ekonomik, gjendjes familjare, statusit të migrimit apo azilit, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë dhe ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre, jetojnë të mbrojtur nga çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, zhvillohen në mënyrë të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe përfshihen në mënyrë kuptimplote në jetën familjare, shkollore dhe komunitare, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.*”

### **Qëllimi i përgjithshëm:**

Të krijohet një sistem vendor i qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe funksional i mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Kamëz, i cili garanton identifikim të hershëm, referim të koordinuar dhe ndërhyrje cilësore për çdo fëmijë në risk; siguron akses në shërbime të integruara sociale, arsimore dhe shëndetësore; parandalon institucionalizimin dhe promovon kujdesin familjar si zgjedhje primare; si dhe mbron të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

### **Objektivat specifikë:**

O1. Funksionalizimi i plotë i strukturave vendore të koordinimit dhe referimit (PMF, NJMF, mekanizmat ndërinstucionalë).

O2. Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve vendorë (menaxhim rasti, politikat e mbrojtjes, kodë i etikës, ndërhyrje e hershme, dhuna me bazë gjinore, dhuna në familje, deinstitutionalizimi, kujdesi alternativ, mbrojtja nga të gjitha format e dhunës).

O3. Zhvillimi i paketës së shërbimeve të specializuara për fëmijën dhe familjen (Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen, Qendra Multifunkionale, shërbimi lëvizës, ndërhyrje e hershme, këshillim prindëror, etj).

O4. Parandalimi i institucionalizimit dhe promovimi i kujdesit alternativ familjar (foster/kinship), përfshi riintegrim familjar aty ku është e mundur.

O5. Përfshirja në arsim, shëndetësi dhe programe socio-ekonomike për familjet me risk, me theks te fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

O6: Zbatimi i qasjes së drejtësisë miqësore për fëmijët për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin: parandalim, devijim nga procedurat penale kur është e mundur, menaxhim rasti ndërsektorial dhe riintegrim në komunitet/arsim.

O7. Sistemi i të dhënave dhe monitorimit.

O8. Ndërgjegjësim publik dhe angazhim komunitar (fushata, prindërim pozitiv, barazi gjinore, diversitet).

O9. Siguria dhe mbrojtja e të dhënave personale sipas ligjit dhe standardeve të UNICEF/GDPR.

## **6. QEVERISJA DHE MEKANIZMAT E KOORDINIMIT**

Zbatimi i Planit mbikëqyret politikisht nga Kryetari i Bashkisë dhe Nënkyetarja për Çështje Sociale, ndërsa zbatues përgjegjës është Drejtoria e Shërbimeve Sociale (NJMF/PMF). Koordinimi operacional realizohet përmes grupeve teknike ndërsektoriale, me përfaqësim nga strukturat e bashkisë për mbrojtjen e fëmijëve, arsimit, shëndetësinë, policinë. Partneriteti institucional përfshin shkollat, qendrat shëndetësore, Shërbimin Social Shtetëror, Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Policinë, Gjykatën/Prokurorinë, njësitë vendore dhe OSHC-të (p.sh., Nisma ARSIS, Terre des Hommes, Save the Children, World Vision, UN Woman etj), si dhe angazhimin e komunitetit dhe familjeve kujdestare. Sekretariatit teknik e ushtron Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në bashkërendim me Njësinë e Monitorimit të Projekteve, duke siguruar ndjekjen e zbatimit, raportimin periodik dhe kohezionin ndërinstitutional.

## **7. SHTYLLAT STRATEGJIKE**

Plani Vendor i Mbrojtjes së Fëmijëve 2026–2030 ndërtohet mbi dhjetë shtylla strategjike të cilat kthejnë vizionin dhe objektivat SMART në veprime konkrete, të koordinuara dhe të matshme. Secila shtyllë mbështet funksionimin e plotë të sistemit lokal të mbrojtjes së fëmijëve, duke lidhur ndërhyrjet sociale, institucionale dhe komunitare.

1. Qeverisja dhe koordinimi ndërsektorial

Kjo shtyllë synon të krijojë dhe konsolidojë mekanizma të qëndrueshëm bashkërendimi midis bashkisë, shkollave, shëndetësisë, policisë, institucioneve të drejtësisë dhe OJF-ve. Përmes rregulloreve të miratuara, kalendarëve të përbashkët pune dhe tryezave tremujore, garantohen reagim i menjëhershëm, ndarje e qartë rolesh dhe përgjegjësish, si dhe zbatimimi i protokolleve standarde 24/7.

**1.1** Ngritja dhe Konsolidimi i Këshillit Vendor Ndërsektorial të Referimit për mbrojtjen e fëmijëve; miratimi i Rregullores së Brendshme

**2.** Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja në terren

Plani vendos në qendër identifikimin proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Kjo përfshin trajnimin e stafit për sinjalet e riskut, përdorimin e formularëve unikë, referime të menjëhershme dhe vizita sistematike në lagje periferike. Synimi është që asnjë rast të mos mbetet i paidentifikuar dhe ndërhyrja të ndodhë sa më herët.

**3.** Shërbimet e specializuara për fëmijën dhe familjen

Qendra Multifunkionale bëhet boshti kryesor i shërbimeve të integruara, duke ofruar terapi zhvillimore, logopedi, fizioterapi, këshillim psikologjik dhe shërbime vlerësimi. Lista e pritjes reduktohet, oraret zgjerohet, ndërsa matja e progresit bëhet standard. Kjo shtyllë synon rritjen e aksesit në shërbime cilësore për të gjithë fëmijët, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara.

**4.** Parandalimi i institucionalizimit dhe kujdesi alternativ familjar

Plani vendos prioritet që fëmijët të rriten në mjedis familjar. Krijohen programe për rekrutimin e familjeve kujdestare, mbështetje financiare dhe psiko-sociale pas vendosjes së fëmijës, si dhe monitorim i rregullt pas riintegrit. Qëllimi është për të shmangur vendosjet e panevojshme në institucione dhe për të mbështetur zgjidhje afatgjata, njerëzore dhe të sigurta.

**5.** Fëmijët në situatë rruge

Përmes një ekipi të dedikuar outreach dhe një protokollit të unifikuar me Policinë, Zyrën Arsimore dhe OJF-të, Plani siguron identifikim të shpejtë, marrje në mbrojtje dhe reintegrim social e arsimor për fëmijët në rrugë. Synohet ulja e ndjeshme e rasteve të përsëritura dhe ofrimi i suportit afatgjatë për fëmijët dhe familjet e tyre.

**6.** Përfshirja Sociale: arsim, shëndetësi dhe ndihmë për familjet në risk

Fokus i kësaj shtylle është rikthimi dhe qëndrueshmëria në arsim për fëmijët me braktisje ose risk të lartë, shërbime shëndetësore të përshtatura dhe lidhje me programe ekonomike e punësimi për prindërit. Mbështetja shkon përtej situatave emergjente, duke adresuar shkaqet që çojnë fëmijët drejt riskut dhe marginalizimit.

**7.** Politikat e Mbrojtjes

Stafi, institucionet dhe partnerët trajnohen detyrimisht për standardet mbrojtëse, menaxhimin e rasteve të dhunës dhe raportimin e sigurt. Protokollet 24/7, planet e sigurisë dhe mekanizmat e kontrollit sigurojnë trajtim profesional, konfidencial dhe të menjëhershëm të çdo denoncimi apo rreziku.

**8.** Komuniteti, prindërimi pozitiv dhe barazia sociale

Plani parashikon fushata ndërgjegjësimi, takime komunitare, aktivitete në shkolla, forume publike dhe materiale informuese për prindër e fëmijë. Qëllimi është të krijohet një kulturë komunitare që mbrohet fëmijët, nxit raportimin dhe parandalon dhunën, diskriminimin dhe shfrytëzimin.

#### 9. Sistemi i të dhënave dhe monitorimit.

Për të siguruar monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e rezultateve, çdo rast raportohet çdo 3 muaj pranë ASHDMF-së, duke mundësuar një analizë të detajuar tremujore dhe një vlerësim të plotë vjetor të ecurisë. Kjo do të kontribuojë në rritjen e cilësisë dhe llogaridhënies, ndërkohë që respektohen plotësisht standardet e etikës, konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave dhe kërkesat e Ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave.

#### 10. Kapacitetet profesionale, supervizimi dhe qëndrueshmëria

Plani parashikon trajnime të akredituara, supervizim profesional dhe mentorim për punonjësit e vijës së parë, duke siguruar standard të njëjtë shërbimi edhe kur ka lëvizje stafi. Kjo shtyllë ruan kujtesën institucionale dhe mban sistemin funksional edhe pas përfundimit të projekteve.

Këto shtylla strategjike kanë orientuar hartimin e matricës operacionale të planit të veprimit të paraqitur më poshtë. **Plani i Veprimit – Matrica Operacionale** shërben si instrumenti kryesor i zbatimit të Planit Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve, duke përkthyer objektivat strategjike në veprime konkrete. Ajo përcakton qartë masat, institucionet përgjegjëse, afatet, indikatorët e matjes dhe burimet e nevojshme, për të siguruar monitorim, transparencë dhe llogaridhënie gjatë gjithë periudhës së planit.

### 8. MONITORIM & VLERËSIM (M&V)

Për zbatimin efektiv të Planit Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Kamëz do të aplikojë një sistem të strukturuar të Monitorimit dhe Vlerësimit, i cili synon matjen e progresit, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ndërhyrjeve. Procesi i M&V do të kryhet nëpërmjet mekanizmave të rregullt të raportimit, analizës së të dhënave dhe mbledhjes së evidencës në terren.

Raportimi periodik do të realizohet çdo 3 muaj, nga punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Qendra Multifunkcionale, dhe do të konsolidohet nga Njësia e Mbrojtjes Sociale në një raport tremujor të performancës, që paraqitet në nivel institucional dhe komunitar. Baseline do të vendoset në fillim të vitit të parë të zbatimit bazuar në të dhënat ekzistuese mbi fëmijët në risk, shërbimet dhe indikatorët standardë. Një vlerësim i ndërmjetëm (mid-term review) do të kryhet në fund të vitit të dytë për të analizuar progresin, sfidat dhe për të rikalibruar ndërhyrjet. Në fund të periudhës 2026–2030 do të përgatitet endline dhe raport vlerësimi përfundimtar për të matur ndikimin e planit.

Sistemi mbështetet në parimet e menaxhimit të përshtatshëm, duke lejuar që planifikimi dhe ndërhyrjet të përshtaten në kohë reale sipas të dhënave, situatave emergjente ose nevojave që shfaqen. Monitorimi i brendshëm do të kombinohet me mbledhje të feedback-ut nga komuniteti, institucionet partnere dhe fëmijët përmes anketave, takimeve publike dhe raststudimeve.

Ky mekanizëm siguron llogaridhënie të qartë, vendimmarrje të bazuar në evidencë dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve për fëmijët në Bashkinë Kamëz.

## 9. ETIKA, KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

### *Qëllimi dhe parimet*

PVMF synon të garantojë që çdo shërbim për fëmijët dhe familjet në Bashkinë Kamëz të zbatohet në përputhje me standardet etike profesionale, me respekt të plotë për dinjitetin njerëzor, privatësinë dhe të drejtat e fëmijës.

Zbatimi i PVMF 2026–2030 udhëhiqet nga parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe kuadrit ligjor kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve.

- **Interesi më i lartë i fëmijës** është konsiderata parësore në çdo vendimmarrje dhe veprim që lidhet me fëmijët.
- **Barazia dhe mosdiskriminimi** – çdo fëmijë gëzon të drejta të barabarta, pavarësisht karakteristikave individuale apo familjare
- **Proporcionaliteti** dhe qëllimi i qartë i çdo përpunimi; përpunohen vetëm të dhënat e domosdoshme për shërbimin.
- **Transparenca dhe llogaridhënia:** kuadri i qartë ligjor, rolet, përgjegjësitë dhe gjurmueshmëria e vendimeve.
- **Konfidencialiteti dhe siguria:** masa teknike/organizative për ruajtjen dhe aksesin e kontrolluar në të dhëna.

Mbrojtja e të dhënave dhe etika bazohen në ligjin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe standardet e BE (GDPR), si dhe aktet në fuqi për të drejtat e fëmijës dhe shërbimet e kujdesit shoqëror.

## 10. ANEKSE

### 1. Qeverisja dhe koordinimi ndërsektorial

Kjo shtyllë synon të krijojë dhe konsolidojë mekanizma të qëndrueshëm bashkërendimi midis bashkisë, shkollave, shëndetësisë, policisë, institucioneve të drejtësisë dhe OJF-ve. Përmes rregulloreve të miratuara, kalendarëve të përbashkët pune dhe tryezave tremujore, garantohej reagim i menjëhershëm, ndarje e qartë rolesh dhe përgjegjësish, si dhe zbatimi i protokolleve standarde 24/7.

### 2. Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja në terren

Plani vendos në qendër identifikimin proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Kjo përfshin trajnimin e stafit për sinjalet e riskut, përdorimin e formularëve unikë, referime të menjëhershme dhe vizita sistematike në lagje periferike. Synimi është që asnjë rast të mos mbetet i paidentifikuar dhe ndërhyrja të ndodhë sa më herët.

### 3. Shërbimet e specializuara për fëmijën dhe familjen

Qendra Multifunkionale bëhet boshti kryesor i shërbimeve të integruara, duke ofruar terapi zhvillimore, logopedi, fizioterapi, këshillim psikologjik dhe shërbime vlerësimi. Lista e pritjes reduktohet, oraret zgjerohet, ndërsa matja e progresit bëhet standard. Kjo shtyllë synon rritjen e aksesit në shërbime cilësore për të gjithë fëmijët, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara. Në funksion të rritjes së aksesit, Bashkia ka ngritur dhe po zbaton shërbimin lëvizës, si dhe transportin social, të cilat garantojnë që fëmijët që jetojnë në zona të largëta ose familjet me vështirësi ekonomike të kenë akses të barabartë në shërbime.

#### 4. Parandalimi i institucionalizimit dhe kujdesi alternativ familjar

Plani vendos prioritet që fëmijët të rriten në mjedis familjar. Krijohen programe për rekrutimin e familjeve kujdestare, mbështetje financiare dhe psiko-sociale pas vendosjes së fëmijës, si dhe monitorim i rregullt pas riintegrit. Qëllimi është për të shmangur vendosjet e panevojshme në institucione dhe për të mbështetur zgjidhje afatgjata, njerëzore dhe të sigurta.

#### 5. Fëmijët në situatë rruge

Përmes njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe një protokollit të unifikuar me Policinë, Zyrën Arsimore dhe OJF-të, Plani siguron identifikim të shpejtë, marrje në mbrojtje dhe riintegrim social e arsimor për fëmijët në rrugë. Synohet ulja e ndjeshme e rasteve të përsëritura dhe ofrimi i suportit afatgjatë për fëmijët dhe familjet e tyre.

#### 6. Përfshirja Sociale: arsim, shëndetësi dhe ndihmë për familjet në risk

Fokus i kësaj shtylle është rikthimi dhe qëndrueshmëria në arsim për fëmijët me braktisje ose risk të lartë, shërbime shëndetësore të përshtatura dhe lidhje me programe ekonomike e punësimi për prindërit. Mbështetja shkon përtej situatave emergjente, duke adresuar shkaqet që çojnë fëmijët drejt riskut dhe marginalizimit.

#### 7. Politikat e Mbrojtjes

Stafi, institucionet dhe partnerët trajnohen detyrimisht për standardet mbrojtëse, menaxhimin e rasteve të dhunës dhe raportimin e sigurt. Protokollet 24/7, planet e sigurisë dhe mekanizmat e kontrollit sigurojnë trajtim profesional, konfidencial dhe të menjëhershëm të çdo denoncimi apo rreziku.

#### 8. Komuniteti, prindërimi pozitiv dhe barazia sociale

Plani parashikon fushata ndërgjegjësimi, takime komunitare, aktivitete në shkolla, forume publike dhe materiale informuese për prindër e fëmijë. Qëllimi është të krijohet një kulturë komunitare që mbron fëmijët, nxit raportimin dhe parandalon dhunën, diskriminimin dhe shfrytëzimin.

#### 9. Sistemi i të dhënave dhe monitorimit

Për të siguruar monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e rezultateve, çdo rast raportohet çdo 3 muaj pranë ASHDMF-së, duke mundësuar një analizë të detajuar tremujore dhe një vlerësim të plotë vjetor të ecurisë. Kjo do të kontribuojë në rritjen e cilësisë dhe llogaridhënies, ndërkohë që respektohen plotësisht standardet e etikës, konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave dhe kërkesat e Ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave".

#### 10. Kapacitetet profesionale, supervizimi dhe qëndrueshmëria

Plani parashikon trajnime të akredituara, supervizim profesional dhe mentorim për punonjësit e vijës së parë, duke siguruar standard të njëjtë shërbimi edhe kur ka lëvizje stafi. Kjo shtyllë ruan kujtesën institucionale dhe mban sistemin funksional edhe pas përfundimit të projekteve.

### 11. Plani i Veprimit – Matrica Operacionale

Plani i veprimit për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Kamëz						
Qeverisja dhe koordinimi ndërsektorial						
Objektiv I						
Masat dhe veprimtaritë	Rezultatet	Institucionet përgjegjëse/inst. partnere	Buxhet	Afatet kohore		
1.1 Ngritja dhe Konsolidimi i Këshillit Vendor Ndërsektorial të Referimit për mbrojtjen e fëmijëve; miratimi i Rregullores së Brendshme			Nuk ka kosto	2026		
1.1.1 Hartimi dhe Miratimi i Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Kamëz për ngritjen e Këshillit Ndërsektorial të Referimit dhe Mbrojtjes së Fëmijëve dhe grupit të punës në nivel teknik	Akt i miratuar Mbledhje e KNRMF	Kabineti i Kryetarit/ DNECS	-	2026		
1.1.2 Hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme i rolit dhe përgjegjësi të anëtarëve të KVRMF dhe grupit teknik për zbatimin e planit vendor të mbrojtjes së fëmijëve	Akt i miratuar Kalendar vjetor pune Plan pune i miratuar	Kabineti i Kryetarit/ DNECS/ Shërbime Sociale Arsim/Shëndetësi/Polici/OJF/ Urdhri i Psikolog/Punonjësit Sociale/ Kryqi i Kuq, etj	-	2026		
1.1.3 Hartimi dhe miratimi i protokollit të përbashkët ndërinstitucional për shkëmbimin e të dhënave ndërsektoriale dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (përfshirë dhe në kushtet e emergjencës)	Dokument i miratuar Minuta takimi	Bashkia Kamëz	-	2026		
1.1.4 Zhvillimi i mbledhjeve periodike të këshillit në nivel drejtues dhe nivel teknik për ndjekjen dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve të PVMF	Cdo 3 muaj / ad-hoc	Bashkia Kamëz	-	2026-2030		

<p><b>1.1.5 Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit të mbrojtjes së shtresave në nevojë për mbrojtje përfshirë dhe fëmijët, në kushtet e emergjencave civile.</b></p>	<p>Fëmijët dhe familjet në nevojë kanë akses në shërbime bazë gjatë emergjencave.</p> <p>Koordinimi mes strukturave (sociale, arsimore, shëndetësore, emergjencave) është efektiv dhe i dokumentuar.</p> <p>Reduktohet rreziku për ekspozimin e fëmijëve ndaj situatave të pasigurta gjatë emergjencave.</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Bashkia Kamëz/Ministritë Përkatese</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>1.2 Hartëzimi i shërbimeve</b></p>	<p><b>1.2.1 Takime me strukturat shërbimofruese dhe organizatat joqeveritare mbi zbatimin e projekteve dhe mbulimin e zonave të njësive administrative me shërbime për fëmijën dhe familjen</b></p>	<p>Bashkia Kamëz Organizata partnere Komisariati i Policisë nr.5 Institucionet arsimore</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>1.2.2 Përditësimi i hartës së shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjen në Bashkinë kamëz</b></p>	<p>Harta e përditësuar cdo 6 muaj</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>Monitorimi dhe rivlerësimi i ecurisë së planeve të ndihmës për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje</b></p>	<p>25 takime në vit</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Burimet njëzore</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>Mbledhje të GTN/ETN në mënyrë periodike dhe ad hoc</b></p>				
<p><b>Objektiv II</b></p>	<p><b>Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja në terren</b></p>			

Masat dhe veprimtaritë	Rezultatet	Institucionet përgjegjëse/inst.partnere	Buxhet	Afatet kohore
<p><b>2.1 Identifikimi i hershëm dhe parandalimi përmes fuqizimit të mekanizmit të raportimit ( përfshirë braktisjen e shkollës, të miturit në konflikt me ligjin)</b></p>			-	
<p><b>2.1.1 Vijimësia e shërbimit lëvizës vlerësues dhe monitorues në familje me përbërjen e psikologut, fizioterapistit, logopedit etj.</b></p> <p><b>Vijimësia e transportit social.</b></p>	<p>Ngritja e shërbimit lëvizës dhe e transportit social për komunitetet vulnerabël përbën një element të rëndësishëm të shërbimeve sociale, duke mundësuar lëvizjen dhe aksesin në shërbime themelore për individët që përballen me vështirësi fizike, financiare ose gjeografike. Kjo iniciativë ka marrë një feedback shumë pozitiv nga të gjithë përfituesit.</p>	Bashkia Kamëz	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
<b>Objektiv III</b>	<b>Shërbimet e specializuara për fëmijën dhe familjen</b>			
Masat dhe veprimtaritë	Rezultatet	Institucionet përgjegjëse/inst.partnere	Buxhet	Afatet kohore

<b>3.1 Fuqizimi i shërbimeve ekzistuese dhe ngritja e shërbimeve të reja të specializuara</b>					2026-2030
<b>3.1.1</b>	Ofrimi i shërbimeve këshilluese për prindërimin pozitiv	15 prindër në vit 10 shërbime këshilluese në vit	Bashkia Kamëz/Shërbimi Lëvizës/Partnerë	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
<b>3.1.2</b>	Ofrimi i shërbimeve terapeutike për fëmijët me aftësi të kufizuara	120 fëmijë në vit 300 seanca terapeutike në vit	Bashkia Kamëz/Shërbimi Lëvizës/ Qendra Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara/Partnerë	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
<b>3.1.3</b>	Ofrimi i shërbimit psikologjik/psikoterapeutik për trajtimin e traumave për fëmijët dhe prindërit e tyre	40 prindër në vit 80 seanca psikologjike/psikoterapeutike në vit	Bashkia Kamëz/Shërbimi Lëvizës/ Qendra Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara/Partnerë	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
<b>3.1.4</b>	Ofrimi i shërbimeve të specializuara si logopedi, fizioterapi, sipas nevojave	120 fëmijë në vit 300 seanca terapeutike në vit	Bashkia Kamëz/Shërbimi Lëvizës/ Qendra Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara/Partnerë	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
<b>3.1.5</b>	Ofrimi i shërbimit të kujdesit në familje	150 familje	Bashkia Kamëz/ Shërbimi Lëvizës//Partnerë	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
<b>Objektiv IV</b>	<b>Parandalimi i institucionalizimit të fëmijëve dhe kujdesi alternativ familjar</b>				
<b>Masat dhe veprimtaritë</b>		<b>Rezultatet</b>	<b>Institucionet përgjegjëse/inst.partnere</b>	<b>Buxhet</b>	<b>Afatet kohore</b>
<b>4.1 Fuqizimi i punës parandaluese dhe identifikuese e rasteve të fëmijëve dhe familjeve në risk për tu ndarë</b>					
<b>4.1.1 Shërbime fuqizuese për rastet e fëmijëve dhe familjeve në risk për tu</b>		Në varësi të familjeve të identifikuar	Bashkia Kamëz/Partnerë		2026-2030

<p>ndarë, përmes identifikimit të hershëm dhe parandalimit (mbështetje ekonomike, administrative, shërbime direkte, mbështetje për punësim, edukim, )</p>				
<p>4.1.2 Takime periodike të strukturave ndërsektoriale të mbrojtjes së fëmijëve për trajtimin e rasteve në risk</p>	<p>Në varësi të rasteve të identifikuara</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë</p>	<p>Burimet njerëzore</p>	<p>2026-2030</p>
<p>4.1.3 Trajtime për ngritjen e kapaciteteve të stafëve të njësisë administrative, të qendrave shërbimofruese për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë për identifikimin e hershëm dhe parandalimin e rasteve të fëmijëve në risk.</p>	<p>10 trajtime në vit Pjesëmarrës do të jenë të gjithë punonjësit që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e rasteve të fëmijëve</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>
<p>4.2 Fuqizimi i strukturave të kujdesit alternativ</p>				
<p>4.2.1 Ngritja e Komisionit Multidisiplinar për vlerësimin e familjeve kujdestare, në përputhje me kuadrin ligjor</p>	<p>Urdhri i Kryetarit Formalizimi i Komisionit</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Nuk ka kosto</p>	<p>2026-2030</p>
<p>4.2.2 Identifikimi i familjeve kujdestare, vlerësimi, trajtimi i tyre dhe regjistrimi në regjistrin e familjeve kujdestare në Bashki.</p>	<p>Regjistri i familjeve kujdestare</p>	<p>Komisioni Multidisiplinar i kujdestarisë alternative/Bashkia Kamëz/partnerë joqeveritarë</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>
<p>4.2.3 Mbështetje afatgjatë me shërbime direkte të menaxhimit të rastit për fëmijët në risk për tu ndarë nga familja, fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje , të deinstitutionalizuar dhe të ribashkuar me familjen biologjike</p>	<p>Në varësi të familjeve të identifikuara</p>	<p>Bashkia Kamëz/organizata partnere</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>
<p>4.2.4 Fuqizimi i procesit të monitorimit të fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ / të rikthyer në familjen</p>	<p>Përmes Sektorit të Mbrojtjes së fëmijëve dhe Barazisë Gjinore dhe NJVNR do të kryhet monitorimi dhe</p>	<p>Bashkia Kamëz/organizata partnere</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>

<p>biologjike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet përkatëse</p> <p>4.2.5 Fushata ndërgjegjësimi për rëndësinë e kujdesit alternativ dhe mbështetjen e familjes</p>	<p>mbështetja e fëmijëve në kujdes alternativ/ të rikthyer</p> <p>2 plane aktivitetesh, ku janë të përfshira disa fushata ndërgjegjësuese në komunitet në vit 25 pjesëmarrës në vit</p>	<p>Bashkia Kamëz /Organizata partnere/Shëndetësi/arsim</p>	<p>Burimet njerëzore</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>Objektiv V</b> Fëmijët në situatë rruge dhe në konflikt me ligjin</p>				
<p><b>Masat dhe veprimtaritë</b></p>				
<p>5.1 Zhvillimi i strukturave të DNECS në bashki në përputhje me detyrimet ligjore (VKM nr.121/2018)</p> <p>5.1.1 Funkcionalizimi i Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e fëmijëve në situatë rruge.</p> <p>5.1.2Hartimi dhe miratimi i planit të masave për identifikimin dhe trajtimin e planit të masave për fëmijët në situatë rruge dhe për të miturit në konflikt me ligjin</p>	<p>Rezultatet</p> <p>Identifikimi/ vlerësimi i fëmijëve në situatë rruge dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme.</p> <p>1 Plan masash në vit për parandalimin dhe zbuljen e fenomenit të fëmijëve në situatë rruge dhe për të miturit në konflikt me ligjin</p>	<p>Institucionet përgjegjëse/inst.partnere</p> <p>Bashkia Kamëz /Partnerë</p> <p>Bashkia Kamëz/ Partnerë/ Komisarriati i Policisë nr.5</p>	<p>Buxhet</p> <p>Bashkia Kamëz</p> <p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Afatet kohore</p> <p>2026-2030</p> <p>2026-2030</p> <p>2026-2030</p>
<p>5.1.3Shërbime të menaxhimit të rastit për familjet e fëmijëve me nivel të lartë rrisht dhe cënueshmërie (që kanë probleme me braktisjen e shkollës, konflikt me ligjin, të prekur nga abuzimi, nga shfrytëzimi dhe abuzimi , pjesë e skemave të NE, AK, etj)</p>	<p>Në varësi të rasteve</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>

<p><b>5.1.4</b>Programe mbështetëse dhe trajtimi për të miturit mbi 7 vjeç, të cilët janë në risk për tu përfshirë në konflikt me ligjin</p>	<p>Në varësi të dinamikave do të ofrohet edhe shërbimi (psikologjik, terapeutik, ndihma financiare etj)</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>Objektiv VI</b></p>	<p>Përfshirja Sociale: arsim, shëndetësi dhe ndihmë për familjet në risk</p>			
<p><b>Masat dhe veprimtaritë</b></p>	<p>Rezultatet</p>	<p>Institucionet përgjegjëse/inst. partnere</p>	<p>Buxhet</p>	<p>Afatet kohore</p>
<p><b>6.1</b> Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për promovimin e kujdesit shëndetësor, arsimor- edukativ, kujdesin alternativ si dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin nga të gjitha format e abuzimit, dhunës dhe shfrytëzimit apo cdo rrezik tjetër</p>				
<p><b>6.1.1</b>Hartimi dhe miratimi i kalendarit vjetor me temat dhe ccëshjtjet për fushatat e ndërgjegjësimit</p>	<p>Kalendar i miratuar, ku janë të përcaktuara aktivitetet të ndryshme me tematika që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve (çështje të trafikimit, internet i sigurt, dhuna etj)</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>6.1.2</b>Hartimi dhe përgatitja e fletëpalosjeve , mesazheve promovuese , pjesëmarrja në mediat lokale dhe sociale për ccëshjtjet e miratuara që lidhen me kujdesin shëndetësor, arsimor, edukativ, mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës dhe kujdesin alternativ.</p>	<p>Dokumentacion</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>

<p><b>6.1.3</b>Zhvillimi i fushatave dhe aktivitetete ndërgjegjesuese për çështjet e caktuara (Dhuna në familje)</p>	<p>1 fushatë e përvitshme e 16-Ditëve të Aktivizimit kundër DHBGJ 2 Plane aktivitetesh për çështje që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve Pjesëmarrës: 25 persona për çdo aktivitet</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë/ Institucionet Arsimore/ Shëndetësore/Komisariati i Policisë nr.5</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>6.1.4</b>Takime dhe aktivitete periodike të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në bashkëpunim me sektorët psikosociale në arsim dhe shëndetësi mbi promovimin e të drejtave të fëmijëve , kujdesin ndaj vetes.</p>	<p>5 takime në vit 15 pjesëmarrës</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë/ Institucionet Arsimore/ Shëndetësore/Komisariati i Policisë nr.5</p>	<p>Burimet njerëzore.</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>6.1.5</b>Zhvillimi i tryezave /forumeve vjetore për parandalimin, identifikimin e hershëm dhe mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës dhe shfrytëzimit.</p>	<p>2 takime në vit 15 pjesëmarrës</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë/ Institucionet Arsimore/ Shëndetësore/Komisariati i Policisë nr.5</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>Objektiv VII</b> Politikat e Mbrojtjes dhe pjesëmarrja e fëmijëve</p>				
<p><b>Masat dhe veprimtaritë</b></p>				
<p><b>7.1</b> Miratimi dhe zhvillimi i politikave të mbrojtjes për stafin, fëmijët dhe përfituesit</p>	<p>Rezultatet</p>	<p>Institucionet përgjegjëse/inst.partnere</p>	<p>Buxhet</p>	<p>Afatet kohore</p>
<p><b>7.1.1</b> Hartimi i modulit të trajnimit dhe zhvillimi i trajnimeve për stafet shërbimofruese</p>	<p>Trajnime të paktën 1 herë në vit</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë</p>		<p>2026-2030</p>
<p><b>7.2</b>Përfshirja e fëmijëve në të gjitha vendimet që do të merren për fëmijët dhe të drejtat e tyre</p>				

<p><b>7.2.1</b>Organizimi i takimeve periodike me pjesëmarrjen e fëmijëve në shkolla për konsultimet mbi zhvillimin e aktiviteteve të planit si dhe vendimmarrjes që kanë të bëjnë me to në Bashki</p>	<p>4 takime në vit 20 fëmijë pjesëmarrës</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>7.2.2</b> Promovimi i politikave të mbrojtjes për fëmijët me gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme dhe miqësore</p>	<p>10 takime në vit 25 fëmijë pjesëmarrës</p>	<p>Bashkia Kamëz/Partnerë/ Institucione arsimore/ Komisariati i Policisë nr.5</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>Objektiv VIII</b> Komuniteti, prindërimi pozitiv dhe barazia sociale</p>				
<p><b>Masat dhe veprimtaritë</b></p>				
<p><b>8.1</b>Bashkia siguron qasje në hapësirat dhe mundësi në lojra dhe argëtim për të gjithë fëmijët me bashkisë</p> <p><b>8.1.1</b> Shtimi i ambienteve për lojra dhe argëtim, organizimi për qasje të sigurtë për lojra dhe argëtim në parqe dhe mjedise rekreative.(përfshirë dhe aksesin për fëmijët me aftësi të kufizuara)</p>	<p>Rezultatet</p> <p>Parku i Liqenit të Paskuqanit ofron ambiente për lojra, fusha sporti, amfiteatër dhe park lojërash, të dizajnuara për të qenë të aksesueshme edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Krahas kësaj në çdo njësi/lagje administrative ka të vendosur lojra apo argëtime për fëmijët.</p>	<p>Institucionet përgjegjëse/inst.partnere</p> <p>Drejtoria e parqeve Drejtoria e infrastrukturës Drejtoria për planifikim urbanistik Mekanimzmi Koordinues dhe OIQ</p>	<p>Buxhet</p> <p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Afatet kohore</p> <p>2026-2030</p>
<p><b>8.1.2</b>Zhvillim i aktiviteteve sociale kulturore në bashkëpunim me shkollat dhe Pallatin e Kulturës “Artan Cuku” Kamëz.</p>	<p>Fëmijët të cilët menaxhohen nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve janë pjesë e lojërave dhe argëtimit në ditët e shënuara për fëmijët.</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Partnerë Pallati i Kulturës Drejtoria Arsimore</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>2026-2030</p>
<p><b>8.2</b> Fushata ndërgjegjësimi dhe puna në komunitet</p>				

8.2.1 Trajnimi i vullnetarëve në komunitet (prindër/ të rinj) për sinjalizim, parandalim, referim.	5 vullnetarë të trajnuar -Në varësi të rasteve	Bashkia Kamëz/ Partnerë/ komunitet	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
8.2.2 Këndet "Shkolla-Komunitet": ditë informuese në shkolla/ qendra komunitare (internet i sigurt, bullizëm, trafik, puna e fëmijëve).	14 aktivitetet 40 fëmijë	Bashkia Kamëz/ Partnerë/ Komunitet/Institucione arsimore	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
8.2.3 Iniciativa rinore komunitare-konkurs për nxitjen e ideve : 5 nisma nga grupet e komunitateve sipas njësive administrative (p.sh., hapësirë lojërash inkluzive, murale sensibilizuese).	2 nisma 20 të rinj	Bashkia Kamëz/ Partnerë/ Komunitet	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
8.3.4 "Flet Komuniteti": takime të hapura me prindër, të rinj, mësues, punonjës socialë me synim trajtimin e sfidave dhe ofrimin e zgjidhjeve.	3 takime 20 pjesëmarrës	Bashkia Kamëz/ Partnerë/ Komunitet	Bashkia Kamëz/Donatorë	2026-2030
8.4 Barazia sociale & përfshirja				
8.4.1 "Dera e Hapur" te shërbimet sociale (1 ditë/ muaj): orientim për ndihmën ekonomike, shërbimet psikosociale, kujdesin alternativ, shërbimet për PAK.	8 takime Komuniteti	Bashkia Kamëz	Bashkia Kamëz	2026-2030
<b>Objektiv IX</b>	Sistemi vendor i të dhënave, monitorimi dhe vlerësimi i PVMF			
<b>Masat dhe veprimtaritë</b>	Rezultatet	Institucionet përgjegjëse/inst.partnere	Buxhet	Afatet kohore
9.1 Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave				
9.1.1 Zhvillimi dhe përdorimi i një sistemi të të dhënave dhe monitorimit për çdo rast, me raportim tremujor	Të gjitha rastet e menaxhuara raportohen çdo 3 muaj pranë ASHDMF-së.	Bashkia Kamëz		2026-2030

<p>pranë ASHDMF-së, për të mundësuar analizë të detajuar, vlerësim vjetor të ecurisë dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve</p>				2026-2030
<p>9.1.2 Përdorimi i Sistemit të SHKSH-së për regjistrimin, monitorimin dhe raportimin e çdo rasti për të mundësuar analizë të detajuar, përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve dhe respektim të standardeve etike dhe ligjore për mbrojtjen e të dhënave.</p>	<p>Të gjitha rastet e fëmijëve që paraqesin nevojën për shërbim (përfshirë edhe fëmijët me AK që referohen pranë Qendrës Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Qendra Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara)</p>	<p>Burimet njerëzore</p>	
<p>9.1.3 Trajtime për stafin për mirëmbajtjen e rregjistrimit, popullimin etë dhënave, miratimin e informuar dhe trajtimin e incidenteve</p>	<p>2 trajtime në vit</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Donatorë</p>	2026-2030
<p>9.2Ndërtimi i një sistemi të koordinuar për monitorimin dhe vlerësimin (M&amp;V) të planit</p>				
<p>9.2.1Hartimi dhe publikimi i një raporti vjetor mbi zbatimin e Planit Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve</p>	<p>1 forum vjetor 20 pjesëmarrës (prindër, fëmijë, aktorë lokalë etj)</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	2027-2030
<p>9.2.2 Organizimi i një forumi vjetor të transparencës ku paraqiten progresi, sfidat dhe rekomandimet.</p>	<p>1 raport i përmbledhur</p>	<p>Bashkia Kamëz/ Partnerë</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	2027-2030
<p><b>Objektiv X</b></p>	<p><b>Kapacitetet profesionale, supervizimi dhe qëndrueshmëria</b></p>			
<p><b>Masat dhe veprimtaritë</b></p>	<p>Rezultatet</p>	<p>Institucionet përgjegjëse/inst.partnere</p>	<p>Buxhet</p>	<p>Afatet kohore</p>
<p>10.1 Zhvillimi i stafit në nivel drejtues dhe teknik përmes ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve</p>				
<p>10.1.1 Ngritje kapacitetesh për stafet teknike ndërsektoriale për</p>	<p>3 trajtime në vit</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>		2026-2030

<p>menaxhimin intensiv të rasteve sipas kategorive të vecanta të problematikave të fëmijëve (përfshirë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara) përmes kurikulave të akredituara dhe në përputhje me procedurat standarde të veprimit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikim i hershëm</li> <li>- ndërhyrje në fëmijërinë e hershme</li> <li>- parandalimi i ndarjes së fëmijës nga familja</li> <li>- shërbimi tërëz në familje</li> <li>- menaxhimi i rastit në për fëmijët në nevojë për mbrojtje ( në konflikt me ligjin, situatë rruge, braktisje shkolle, viktima të dhunës, VT/VMT, etj)</li> <li>- mbrojtja e të dhënave</li> <li>- kujdesi alternativ dhe mbështetja afatgjatë</li> <li>- politikat e mbrojtjes së stafit dhe të përfrituesve ( përfshirë mbrojtja nga ngacmimi dhe shfrytëzimi seksual )</li> <li>- nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve</li> <li>- përgatitjen dhe zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese</li> <li>- tema të tjera që janë relevante me zhvillimet sociale të cilat prekin ndjeshëm jetën e komunitetit</li> </ul>	<p>10-15 pjesëmarrës</p>	<p>Bashkia Kamëz/Donatorë</p>	
<p>10.1.2 Mentorim dhe supervizim në punë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- supervizim profesional</li> <li>- supervizim psikologjik</li> <li>- mentorim për punonjësit e vijës së parë</li> </ul>	<p>2 sesioneve të supervizimit 10 pjesëmarrës</p>	<p>Bashkia Kamëz</p>	<p>Bashkia Kamëz 2026-2030</p>